
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-917/2025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, për dhurimin e aparatit fotografik Policisë së Kosovës Njësia në Istog, nxjerr:

V E N D I M

1. **z. Ilir Ferati**, Kryetari i Komunës, dhuron një aparat fotografik Canon EOS R10 RF-S 18-150mm F3.5-6.3 IS STM KIT Policisë së Kosovës Njësia në Istog, qe do t'iu shërbejë gjatë punës së tyre.
2. Obligohen Zyra e Kryetarit të bëjë pranim dorëzimin e aparatit fotografik me të dhëna si në pikën 1 të këtij Vendimi Komandantit të Policisë së Kosovës Njësia në Istog me datën 10.09.2025.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
4. Vendim është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:



- Komandantit të Policisë së Kosovës Njësia në Istog
- Zyrës së Kryetarit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-916/2025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshim e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 09.09.2025 të parashtruar nga Prokurimi për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore te linja e tensionit te Mesëm dhe të larte në zonën e Dubraves-projekt dy vjeçar”, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxheri i kontratës **Grupi i Operatoreve ekonomik P.M.N. SH.P.K.; N.P.N UNIVERS-MI nga Prishtina** për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore te linja e tensionit te Mesëm dhe të larte në zonën e Dubraves-projekt dy vjeçar”, me numër të jashtëm prokurimi 633-025-7826-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-057-521 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për kontratën e lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesit të tenderit.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.
3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekura e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.
5. Vendimi është përfundimtar.



Vendimi i dërgohet:

- Prokurimit,
- Grupi i Operatoreve ekonomik P.M.N. SH.P.K.; N.P.N UNIVERS-MI-Menaxher i kontratës,
- Genc Ademaj, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-915/2025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 09.09.2025 të parashtruar nga Prokurimi, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësorë te linja e tensionit të mesëm dhe të lartë në zonën e Dubravës-projekt dy vjeçar”, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësorë te linja e tensionit të mesëm dhe të lartë në zonën e Dubravës-projekt dy vjeçar”, me numër të brendshëm prokurimi 633-025-075-521 dhe numër të jashtë prokurimi 633-025-7826-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Naser Nimanaj, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Brahim Hetemaj, anëtar;
- 1.3. Drin Sadikaj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësorë te linja e tensionit të mesëm dhe të lartë në zonën e Dubravës-projekt dy vjeçar”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t'iu ofroj qasje në oferta që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:



- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




**Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-914/025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47, 49 dhe neni 53 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), neni 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01.Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe Nenin 1 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1. të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.01/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në Zyrën e Kryetarit, shqyrtoi kërkesën 01Nr.400-20136 të datës 23.06.2025, të parashtruar nga Arjan Llullaku, përfaqësues i lagjes Llullaku nga Istogu, për përkrahje financiare subvencionim për gypin e ujësjellësit në lagjen Llullaku dhe me procesverbal: Nr.91/2025 të datës 30.06.2025, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M


1. **MIRATOHET:** kërkesa 01Nr.400-20136 e datës 23.06.2025, e parashtruar nga Arjan Llullaku, përfaqësues i lagjes Llullaku, për përkrahje financiare subvencionim për gypin e ujësjellësit në lagjen Llullaku për interesin e lagjes dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **1,400.00€ (njëmijekatërqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për interes të lagjes.
2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirrollogarinë e Arjan Llullakut, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Vendimi Nr. 01-643/025 i datës 03.07.2025 shfuqizohet në tërësi.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
5. Vendimi është përfundimtarë.



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Arjan Llullaku,
- Zyrës Kryetarit dhe
- Arkivit të zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-913/025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), bazuar në Nenin 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe bazuar në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën Nr.57/2025 të datës 09.09.2025 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr.01-591/2025 të datës 26.06.2025, për ndërrimin e Menaxherit të kontratës, nxjerr:


V E N D I M

1. **Ndryshohet Plotësohet** Vendimi 01Nr.591/2025 i datë 26.06.2025, për ndërrimin e Menaxherit të kontratës dhe në vend të Muhamet Demaj, Menaxher i Kontratës “Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qeneve endacak” me numër të jashtëm prokurimi 633-025-5019-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-025-221 caktohet Skender Hasangjekaj.
2. Vendimi 01Nr.591/2025 i datës 26.06.2025, mbetet në fuqi të gjitha pikat tjera.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim .
4. Vendimi është përfundimtar.



Vendimi i dërgohet:

- Muhamet Demaj,
- Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
 Z. HIR FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.Br.911/2025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Nenin 10 paragrafi 4 Nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/2019), Nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për qasje në dokumente publike se bashku me Drejtorinë për Administratë Komunale dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit, kanë shqyrtuar kërkesën 01Nr.034-33300 të datës 05.09.2025 të parashtruar nga Floriana Maxharraj, anëtare e Kuvendit të Komunës së Istogut, lënda është pranuar në Sektorin Ligjor me datën 09.09.2025 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.034-33300 e datës 05.09.2025 e parashtruar nga Floriana Maxharraj, anëtare e Kuvendit të Komunës së Istogut dhe i lejohet qasja në dokumente publike si me poshtë:

- 1.1. Energjia elektrike e shpenzuar për vitin 2024 (1janar-31 dhjetor) dhe vitin 2025 (1janar-31 gusht) për secilën shkollë në Komunën e Istogut;
- 1.2. Energjia elektrike e shpenzuar për vitin 2024 (1 janar-31 dhjetor) dhe vitin 2025 (1janar-31gusht) për secilin institucion publik, veç e veç në Komunën e Istogut”;
- 1.3. Numri i aplikimeve dhe numri i fëmijëve të pranuar në secilën çerdhe publike, për secilin vit nga viti 2021.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Zyrtare për Komunikim me Publikun, për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, Drejtoria për Administratë Komunale dhe Drejtoria Komunale e Arsimit, obligohen dokumentet e kërkuara si në pikën 1 të këtij Vendimi, t’i ja dërgojnë Floriana Maxharraj, anëtare e Kuvendit të Komunës së Istogut.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Floriana Maxharraj, anëtare e Kuvendit të Komunës së Istogut, ka parashtruar kërkesën 01Nr.034-33300 të datës 05.09.2025, për qasje në dokumente publike dhe i lejohet qasja në dokumente publike si me poshtë:

-Energjia elektrike e shpenzuar për vitin 2024 (1janar-31 dhjetor) dhe vitin 2025 (1janar-31 gusht) për secilën shkollë në Komunën e Istogut;

-Energjia elektrike e shpenzuar për vitin 2024 (1 janar-31 dhjetor) dhe vitin 2025 (1janar-31gusht) për secilin institucion publik, veç e veç në Komunën e Istogut”;

-Numri i aplikimeve dhe numri i fëmijëve të pranuar në secilën çerdhe publike, për secilin vit nga viti 2021.

Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale dhe Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, kanë shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës së cekur me lartë i propozojnë Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë Komunale, Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimi të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Floriana Maxharraj,
- Drejtorisë për Administratë Komunale,
- Drejtorisë Komunale te Arsimit,
- Jeta Balaj dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-910/025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.21/2023) në fuqi nga 18 shtatori 2023, shqyrtoj kërkesën 02Nr.178-2025 të datës 09.09.2025, të parashtruar nga z Fisnik Shoshaj, Menaxher i Burimeve Njerëzore, qe Abedin Idrizaj, Zyrtar Administrativ në Drejtorinë për Shërbime Publike të transferohet me pagë ne nënprogramin e lirë buxhetor të Bujqësisë sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2025 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 02Nr.178-2025 e datës 09.09.2025, e parashtruar nga z Fisnik Shoshaj, Menaxher i Burimeve Njerëzore, qe Abedin Idrizaj, Zyrtar Administrativ në Drejtorinë për Shërbime Publike të transferohet me pagë ne nënprogramin e lirë buxhetor të Bujqësisë sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2025.
2. Për shkak se në Drejtorin për Shërbime Publike nuk ka pozitë të lirë me pagë atëherë Abedin Idrizaj, Zyrtar Administrativ të transferohet me pagë ne nënprogramin buxhetor të Bujqësisë 47017.
3. Obligohet Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime që këtë Vendim të dërgoj në Ministrinë e Financave Punëve dhe Transfereve-Departamenti i Punësimit për futjen e Abedin Idrizaj, në listën e pagave ne nënprogramin buxhetor të Bujqësisë 47017 si në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Menaxheri Personelit dhe Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:



- z.Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit,
- Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-909/025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58, shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik. Shqyrtoi kërkesën 01Nr.016-33972 të datës 09.09.2025, të parashtruar nga Diana Blakçori-Maxharri, Zyrtare e Lartë për Bujqësi, nga fsh. Cërrcë, Komuna Istogut, për lejimin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesën 01Nr.016-33972 e datës 09.09.2025, e parashtruar nga Diana Blakçori-Maxharri, Zyrtare e Lartë për Bujqësi, nga fsh. Cërrcë, Komuna Istogut, për lejimin e pushimit të lehonisë dhe i lejohet pushimi i lehonisë për 12 muaj nga data **05.09.2025 deri me datën 05.09.2026**.
2. Pushimi i lehonisë për 6 muaj nga data: **05.09.2025 deri me datën 05.03.2026**, kompensohet nga institucioni me 70% të pagës dhe nga data: 05.03.2026, obligohet Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për paga, mëditje dhe kompensime që Dianen të vendos në listën e pagave me zero (0).
3. Mbas gjashtë muajve Diana Blakçori-Maxharri, mund të paraqes kërkesë personalisht në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës për Qeverinë e Republikës së Kosovës për kompensim me 50% të pagës mesatare në Kosovë, për tre muaj nga data: **05.03.2026 deri me datën:05.06.2026** dhe obligohet të dal në punë me datën **06.06.2026** si dhe për tre(3) muaj tjerë pa pagesë mund të parashtror kërkesë me shkrim të Menaxheri i Personelit 15 ditë para fillimit të punës.

A r s y e t i m

Diana Blakçori-Maxharri, Zyrtare e Lartë për Bujqësi, ka parashtruar kërkesë 01Nr.016-33972 e datës 09.09.2025 për lejimin e pushimit të lehonisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës, të njëjtën e miraton në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik dhe Diana Blakçori-Maxharri, i lejohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve, për gjashtë (6) muaj nga data: **05.09.2025 deri me datën 05.03.2026**, kompensohet me 70% të pagës bazë që e merr nga institucioni-Komuna.

Mbas gjashtë muajve Diana Blakçori-Maxharri, mund të paraqes kërkesë personalisht në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës për Qeverinë e Republikës së Kosovës për kompensim me 50% të pagës mesatare në Kosovë, për tre muaj nga data: **05.03.2026 deri me datën: 05.06.2026** dhe obligohet të dal në punë me datën 06.06.2026 si dhe tre (3) muaj tjerë pa pagesë mund të parashtror kërkesë me shkrim të Menaxheri i Personelit 15 ditë para fillimit të punës.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Diana Blakçori-Maxharri,
- Zyrtares Financiare-përgjegjëse për paga, mëditje dhe kompensime,
- Menaxherit të Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-907/2025	Data: Datum: 08.09.2025	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 08.09.2025 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevine, Dreje dhe Lubove”; nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevine, Dreje dhe Lubove”; me numër të jashtëm prokurimi 633-025-7915-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-058-521 dhe në komision caktohen.

- 1.1. Arta Fetahu, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Albert Hasanaj, anëtar;
- 1.3. Shefqet Imeraj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevine, Dreje dhe Lubove”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t’iu ofroj qasje në oferta qe kanë shprehur konkurrencë.


7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:



- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
 Z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. 906 /2025	Data: Datum: 08.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), si dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-32479, të datës 02.09.2025, të parashtruar nga Zenel Sejdaj, nga Istogu, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për nevoja shëndetësore, përkatësisht për dërgimin e tij, në Shërbimin Onkologjik pranë QKUK-së në Prishtinë. Komisioni, me procesverbal Nr. 237/2025, të datës 02.09.2025, i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa 06 Nr. 553-32479, datë 02.09.2025, e parashtruar nga Zenel Sejdaj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e tij, për trajtim me kimioterapi (10 seanca) në Shërbimin Onkologjik pranë QKUK-së, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I miratohen 100 litra lëndë djegëse (karburant).
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë z. Shemsedin Selmanaj me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që do të përdorë parashtruesi i kërkesës, në sasinë e specifikuar në pikën 1 të këtij vendimi. Ky furnizim duhet të realizohet në përputhje me procedurat në fuqi për furnizimin me karburant të automjeteve zyrtare, sipas programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palës së pakënaqur i lejohet të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:



- Zenel Sejdaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj



Kryetar i Komunës
 z. HIR FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. 905/2025	Data: Datum: 08.09.2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), si dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-32949, të datës 03.09.2025, të parashtruar nga Naser Curraj, nga fshati Llukac i Begut, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për nevoja shëndetësore, përkatësisht për dërgimin e nënës së tij Ajkune Curraj, në Shërbimin Onkologjik pranë QKUK-së në Prishtinë. Komisioni, me procesverbal Nr. 235/2025, të datës 04.09.2025, i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa 06 Nr. 553-32949, datë 03.09.2025, e parashtruar nga Naser Curraj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e nënës së tij Ajkune Curraj, për trajtim me kimioterapi (11 seanca) në Shërbimin Onkologjik pranë QKUK-së, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I miratohen 110 litra lëndë djegëse (karburant).
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë z. Naser Curraj me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që do të përdorë parashtruesi i kërkesës, në sasinë e specifikuar në pikën 1 të këtij vendimi. Ky furnizim duhet të realizohet në përputhje me procedurat në fuqi për furnizimin me karburant të automjeteve zyrtare, sipas programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palës së pakënaqur i lejohet të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:



- Naser Curraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj



Kryetar i Komunës
 z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br. <u>904</u> /2025	Data: Datum: <u>08.09</u> .2025	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) dhe në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, e ka shqyrtuar kërkesën 06 Nr. 553-33032 të datës 04.09.2025, të parashtruar nga Fatima Pukaj nga fshati Drejë, Komuna e Istogut, përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e saj, në QKUK - Prishtinë, Komisioni me procesverbal Nr. 236/2025 të datës 04.09.2025, i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

1. **APROVOHET:** Kërkesa 06 Nr. 553-33032, datë 04.09.2025, e parashtruar nga Fatima Pukaj, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant), për dërgimin e saj, në Prishtinë, për trajtimin me Kimio-Terapi, me 10 seanca, në QKUK, në relacionin Istog - Prishtinë dhe anasjelltas. I lejohet 100 litra lëndë djegëse (karburant).
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë Gzim Pukaj me një vërtetim për furnizim me karburant të automjetit që parashtruesi i kërkesës e prezanton, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi. Ky furnizim duhet të bëhet në përputhje me procedurat e furnizimit me karburant të automjeteve zyrtare që vlen në programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij. Për zbatimin e tij do të përzgjidhen Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë një konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:



- Fatima Pukaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj



Kryetar i Komunës
 z. Ilir FERATI



 Republika Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-903/2025	Data: Datum: 08.09.2025	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 12Nr.60/2025 të datës 29.08.2025 të parashtruar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pranuar në Sektorin Ligjor me datën 08.09.2025, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektet: “Ndërtimi i sallës së sporteve në Vrellë-vazhdim”, dhe aneks kontratën “Ndërtimi i sallës së sporteve në Vrellë-vazhdim punë shtesë”, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektet: “Ndërtimi i sallës së sporteve në Vrellë-vazhdim”, me numër të prokurimit 633-024-7591-521 dhe aneks kontratën “Ndërtimi i sallës së sporteve në Vrellë-punë shtesë”, me numër të prokurimit 633-025-5786-525/C1007, të cilat projekte i ka realizuar operatori ekonomik “NNP “CTA” SH.P.K nga Prishtina dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Rasim Mahmutović**, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Naser Nimanaj**, anëtar dhe;
- 1.3. **Faton Maraj**, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektet e cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartojë raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin e punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektet e lartcekura i merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës.


4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-902/2025	Data: Datum: 08.09.2025	

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën të datës 08.09.2025 të parashtruar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e Specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin: “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Lluga” dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M



1. **Emërohet: Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, për hartimin e Specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin: “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Lluga”;
2. I lartpërmenduri obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nën Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Naser Gjocaj,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Prokurimit, dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-918/2025	Data: Datum: 09.09.2025	

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, në Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) dhe në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, për projektin “Banimi Social Adekuat” në Kosovë. Për themelimin e Njësitit të Implementimit të projektit për rindërtimin e shtëpive dhe renovimin e shtëpive private për familjet apo individët e cenushme në kuadër të projektit të “Banimit Social Adekuat” në komunën së Istogut, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Njësitit për Implementimin e projektit për rindërtimin e shtëpive dhe renovimin e shtëpive private për familjet apo individët e cenushme në kuadër të projektit të “Banimit Social Adekuat” në komunën e Istogut dhe në Njësit caktohen:

- 1.1. **Brahim Hetemaj**, Kryesues i Njësitit për IP,
- 1.2. **Jakup Blakaj**, anëtar;
- 1.3. **Aurela Sadikaj**, anëtare;
- 1.4. **Zekije Sutaj**, anëtare;
